

Statistikat e Transportit Hekurudhor

Tremujori III, 2023


Tiranë, më 27 Tetor 2023: Gjatësia e rrjetit hekurudhor në shfrytëzim në vend është 204 km. Në shfrytëzim janë linjat hekurudhore: Kufi - Gjorm 93 km, Durrës - Elbasan 76 km, Fier - Vlorë 35 km. Transporti hekurudhor i mallrave kryhet në distanca 0 - 49 km dhe 50 - 150 km.

Statistikat e Transportit hekurudhor, për tremujorin e tretë 2023, paraqiten si në vazhdim:

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 129 mijë ton, duke u ulur me 7,6 %, në krahasim me tremujorin e tretë 2022.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë në mijë ton-km rezultoi 4.456, duke u ulur me 8,9 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2022.

Fig.1 Transporti hekurudhor i mallrave, 000/ton-km




Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Për publikim 27/10/2023

Sipas klasifikimit NST 2007, në tremujorin e tretë 2023, 97,9 % të mallrave të transportuar me hekurudhë e zënë "Qymyri dhe linjiti, nafta bruto dhe gazi natyror" dhe 2,1 % e zënë "Produkte metalike dhe të minierave dhe produkte të tjera të gurave: torfe, uranium dhe torium".

Në tremujorin e tretë 2023, 2.017 pasagjerë kanë përdorur transportin hekurudhor si mjet udhëtimi, duke shënuar rritje me 56,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Fig. 2 Numri i pasagjerëve në transportin hekurudhor, 000 pasagjerë/km



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Eksportet/importet e mallrave me hekurudhë

Në tremujorin e tretë 2023, volumi i mallrave të tregtuara me hekurudhë (eksport dhe import) është 2.706 tonë. Krahasuar me tremujorin e tretë 2022, ky tregues është rritur me 3,8 herë.

Volumi i mallrave të eksportuara me hekurudhë zë 0,2 % ndaj volumit gjithsej të mallrave të eksportuara në vend. Krahasuar me tremujorin e tretë 2022, volumi i mallrave të eksportuara me hekurudhë është rritur me 3,8 herë.

Tab. 1 Eksportet/importet e mallrave me hekurudhë, ton

Periudha	TR III -2021	TR IV- 2021	TR I- 2022	TR II- 2022	TR I 20: 2022	TR IV- 2022	TR I- 2023	TR II- 2023	TR III- 2023
Eksport	0	0	0	1.104	720	0	2.784	4.622	2.706
Import	1.145	1.843	1.667	1.113	0	0	0	0	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë tremujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve që përdorin një automjet hekurudhor në një rrjet të caktuar hekurudhor.

Gjatësia e shinave: Për një seksion të caktuar hekurudhor është gjatësia midis pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të nisjes dhe pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të terminalit.

Pasagjerë të transportuar me hekurudhë: Do të quhet çdo pasagjerë që udhëton me mjetin hekurudhor, duke përfshirë personat e destinuar për shërbime në tren.

Ton-kilometër (TKM) - Njësia e matjes që përfaqëson lëvizjen e një ton kapaciteti të disponueshëm në një vagon kur kryhet shërbime për të cilat është përcaktuar një distancë kryesisht mbi një kilometër.

Mallra të transportuara me hekurudhë - Do të quhet çdo lëvizje malli që kryhet me mjet hekurudhor, duke përfshirë këtu ambalazhin dhe pajisjet siç janë konteinerët, paletet si dhe mjetet rrugore të mallrave të transportuara me hekurudhë.

Tren-kilometër - janë distancat në kilometra të përshkuara nga trenat.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: transport rrugor, hekurudhë, transport ujor i brendshëm dhe transport detar.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash